

## AKT – THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " ARENA COMPANY" SHPK

Sot ne daten 17.02.2023 , une i nenshkruari :

**Elvis Milaqi**, atësia Xheladin, amësia Fatime, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Raj 5, Rr. Lazer Çausi, lindur më 28/01/1985, I pajisur me Leternjoftim nr. 036717144 dhe nr. personal I50128080F,

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "**ARENA COMPANY**" SHPK.

#### **NENI 1**

##### **EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te quhet "**ARENA COMPANY**" SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-ne .

#### **NENI 2**

##### **SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres Durres DURRES Lagjja 14, Rruga Bajram Tusha, Objekt me Nr.Pasurie 16/410, Zona Kadastrale 8516.

Shoqeria mund te krijojë filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **NENI 3**

##### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Impiante gazi. Tregti me pakicë të automjeteve të përdorura. Shërbime mekanike të ndryshme. Shërbime karrotreci. Tregti me shumicë e pakicë të produkteve bujqësore, fruta-perime. Siguracione për makina. Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura. Import i pjesëve të makinave të dala jashtë përdorimit. Investigim privat. Kerkimi, gjetja, dhe mbledhja e informacioneve personale, familjare, tregtare dhe industriale, te mbartura, te humbura ose aktuale te cilat cojne ne zbardhjen e veprave te konsumuara me karakter penal,civil ose administrative, ose te informacioneve qe bejne te mundur parandalimin e tyre. Ne mbrojtjen e sekreteve industriale, investigimin mbi markat dhe patentat e falsifikuara. Te investigoje dhe te



grumbulloje prova per geshtjet e pabesueshmerise te ortakeve ne biznes si dhe mbi konkurrencen e pandershme dhe jo te vertete. Te kryeje investigime per gjetjen e personave te humbur, bazuar ne kerkesen e familjareve dhe te te interesuarve, si dhe personat qe kerkohen nga organet shteterore. Te siguroje prova, fakte, indicie, materiale dhe informacione per llogari te pales mbrojtese ne procesin penal, si dhe te perfaqesuesve te paleve mbrojtese ne proceset civile dhe administrative. Gjetja e vendodhjeve dhe konfiskimi i pasurive te paluajtshme, te mjeteve motorrike dhe asetave qe rezultojne te vjedhura dhe/ose ne pronesi te paleve te treta. Kerkime mbi identitetin, sjelljet, profesionin, reputacionin, integritetin, besueshmerine, levizjet, 2 transaksionet dhe bizneset qe drejtojne, personat me te cilet kryehet biznes ose do te ndertohet nje marredhenie e re biznesi. Shkaku ose 2 pergjegjesia per renien e zjarrit, humbjeve, aksidenteve, demeve, plagosjeve te per personave te demit te prones dhe imazhit nga shpifjet. Kryerjen e veprimeve ne fushen e zbulimit dhe kunderzbulimit, survejim/kundersurvejim, fiksime te kontakteve me videofilmim. Grumbullon informacion te klasifikuar mbi ngjarje te mprehta, terrorizmin, korrupsionin pasiv/aktiv dhe pastrimin e produktit kriminal per ta kordinuan me strukturat ligjzbatuese. Te investigoje, me qellim vertetimin e ekzistences se marredhenieve jashtemartesore sipas kerkeses se njerit prej partnerevem, ne çdo rast duke respektuar privatesine sipas ligjit mbi mbrojtjen e te dhenave personale. Investigime jashte vendit ne Itali, Greqi, Gjermani. Lojë paintball gun.

**NENI 4**  
**KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali i shoqerise " **ARENA COMPANY**" SHPK eshte 100.000 Leke .  
Ky kapital perbehet nga 1 kuote dhe zoterohet ne masen 100% ,nga ortaku i vetem i saj, zoti Elvis Milaqi.

**NENI 5**  
**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

**NENI 6**  
**ORGANET E SHOQERISE**

- Asambleja e pergjithshme.
- Administratoret.

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:



- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspereve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

## **ADMINISTRATORET**

**Administrator i shoqerise do te jete zoti Elvis Milaqi**, atësia Xheladin, amësia Fatime, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Raj 5, Rr. Lazer Çausi, lindur më 28/01/1985, I pajisur me Leternjoftim nr. 036717144 dhe nr. personal I50128080F, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripërteritje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja , me shumicë të thjeshte te votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

## **NENI 7**

### **Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë**

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

## **NENI 8**

### **Prishja e shoqerise.**

Prishja e shoqerise  
Shoqeria priset :



- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "QKR",
- d) me vendim te gjykates,
- dh) per arsye te tjera ,te parashikuara ne statut.

#### **NENI 9**

##### **Likuidimi i shoqerise.**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës

Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

#### **NENI 10**

##### **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE " ARENA COMPANY" SHPK**

**ELVIS MILAQI**

*Elvis Milaqi*  
